



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pratje - Priloge të Dokumentit			
Nr. Dokumenti Gj. B. Sh.	Nr. Dokumenti Gj. B. Sh.	Nr. Dokumenti Gj. B. Sh.	Vlera Vendnost
01-	110/05-		1495



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dispozitat e nenit 9.1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012, MPB, 03/2012 të MAPL-së për këshillat komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 26.12.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për Vitin 2025

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për Vitin 2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për Vitin 2025, me Nr. të Protokollit 02-035/02-1411, i datës 10.12.2024.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për Vitin 2025 kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

